



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E OBILIQ - OPSTINA OBILIC - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 10-104-02-25832-24

Nr. Titull / Or. Nr. / No. Pg. _____

Data / Datum / Date 05.09.2024

OBILIQ - OBILIC - OBILIC



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republik of Kosova
Komuna e Obiliqit/Opština Obilic/Municipality of Obiliq

Drejtoria e Arsimit

Bazuar në nenet 6 dhe 19 të Rregullores Për Ndarjen E Bursave, Kompensimin E Shpenzimeve Të Udhëtimit Dhe Aktivitet Jashtëshkollor, Nr.-I-104, të datës 31.08.2020, dhe kërkesën me Nr.10-104-02-25587-24-1-1 të datës 5.09.2024, Drejtoria e Arsimit më 05.09.2024 shpall:

KONKURS

(Për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për nxënës për vitin shkollor 2024-2025)

Për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për nxënës të Komunës së Obiliqit të këtyre kategorive:

- 1.Për nxënës nëse distanca e udhëtimit shtëpi-shkollë është së paku 3 kilometra
- 2.Për nxënës me nevoja të veçanta
3. Për nxënës, familjet e të cilëve janë raste sociale, në qoftë se në relacionet e udhëtimit të këtyre nxënësve është i organizuar udhëtimi publik apo privat.
- 4.Për nxënës të Komunës së Obiliqit në shkollat e mesme të larta,që vazhdojnë shkollimin në komunat tjera,por vetëm në drejtimet që nuk janë në shkollat e mesme të larta në Komunën e Obiliqit.

Dokumentet e nevojshme për të gjitha kategoritë :

- Vërtetimi nga shkolla që është nxënës i rregullt dhe për distancën shtëpi-shkollë
- Kopja e letërnjoftimi (në mungesë të letërnjoftimit të sjell certifikatën e lindjes),
- Për rastet nxënës me nevoja të veçanta, të sjellin edhe diagnozën e mjekut
- Për rastet sociale, të sjellin edhe vërtetimin nga Qendra për Punë Sociale në Obiliq.
- Konfirmimi banker i nxënësit ose prindërit
- Letërnjoftimi i nxënësit ose prindërit

Sqarim:Letërnjoftimi dhe konfirmimi i bankës duhet të jenë vetëm të njërit prind

Komisioni për ndarjen e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit e ruan të drejtën, të verifikojë gjendjen faktike të kriterëve të kërkuara sipas konkursit për kandidatët që kanë aplikuar për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit .

Fletëkërkesat merren në Zyrën e pranimit të KK-së ,ose në faqen zyrtare të komunës dhe dorëzohen me dokumente të kompletuara në të njëjtën Zyrë. Afati i konkurrimit është 15 ditë pune.

Drejtoreshë në DA: Fitore Hashani

